**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada - Government***

*Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice*

# UDHËZIM ADMINISTRATIV MD-NR. 05/2022 PËR TARIFAT NOTERIALE PËR KOMPENZIMET[1] PËR PUNËN DHE KOMPENZIMET E SHPENZIMEVE TË NOTERIT

# ADMINISTRATIVE INSTRUCTION MoJ-NO. 05/2022 ON NOTARY FEES FOR COMPENSATION OF[2] NOTARY WORK AND EXPENSES

# ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO MP-BR. 05/2022 O JAVNOBELEŽNIČKIM TARIFAMA ZA[3] NAKNADE ZA RAD I NAKNADE TROŠKOVA JAVNOG BELEŽNIKA

[1] Udhëzim Administrativ MD-Nr. 05/2022 për Tarifat Noteriale për Kompenzimet për Punën dhe Kompenzimet e Shpenzimeve të Noterit, i nënshkruar nga Ministrja e Drejtësisë, më datë 22.07.2022
[2] Administrative Instruction MoJ-No. 05/2022 on Notary Fees for Compensation of Notary Work And Expenses, signed by Minister of Justice, date 22.07.2022
[3] Administrativno Uputstvo MP-Br. 05/2022 O Javnobeležničkim Tarifama Za Naknade Za Rad I Naknade Troškova Javnog Beležnika, je potpisano od strane Ministar Pravde, datum 22.07.2022.

| | | |
|---|---|---|
| **Ministrja e Drejtësisë,** | **The Minister of Justice,** | **Ministarka Ministarstva Pravde,** |
| Në mbështetje të nenit 16, paragrafi, 1 dhe nenit 76 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 06/L-010 për Noterinë (GZ Nr.23, me datë 26.12.2018), duke u bazuar në nenin 8 nënparagrafi 1.4 të Rregullores Nr. 02/2021, për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 si dhe nenin 38 paragrafin 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, me konsultimin paraprak të Odës së Noterëve të Kosovës, Ministrja e Drejtësisë, | Pursuant to Article 16 paragraph 1 and Article 76 paragraph 1 of Law No. 06/L-010 on Notary (OG No. 23, dated 12.26.2018), based on Article 8 sub-paragraph 1.4 of Regulation No. 02/2021 on the Areas of Administrative Responsibility of the Office of the Prime Minister and Ministries, as amended and supplemented by Regulation No. 04/2021, and Article 38 paragraph 6 of the Rules of Procedure of the Government of the Republic of Kosovo No. 09/2011, with the prior consultation of the Notary Chamber of Kosovo, the Minister of Justice, issues the following: | Na osnovu člana 16. stav 1. i člana 76. stav 1. Zakona br. 06/L-010 o notarima (Sl. List br. 23, od 12.26.2018.), na osnovu člana 8. stav 1.4 Uredbe br. 02/2021 o oblastima administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstava, izmenjena i dopunjena Uredbom br. 04/2021, kao i člana 38. stav 6. Pravilnika o radu Vlade Republike Kosovo br. 09/2011, uz preliminarne konsultacije sa Javnobeležničkom komorom Kosova, Ministarstvo pravde donosi: |
| **Nxjerr:** | **Issues:** | **Izdaje:** |
| **UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 05/2022 PËR TARIFAT NOTERIALE PËR KOMPENZIMET PËR PUNËN DHE KOMPENZIMET E SHPENZIMEVE TË NOTERIT** | **ADMINISTRATIVE INSTRUCTION NO. 05/2022 ON NOTARY FEES FOR COMPENSATION OF NOTARY WORK AND EXPENSES** | **ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO BR. 05/2022 O JAVNOBELEŽNIČKIM TARIFAMA ZA NAKNADE ZA RAD I NAKNADE TROŠKOVA JAVNOG BELEŽNIKA** |

| KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME | CHAPTER I GENERAL PART | POGLAVLJE I OPŠTE ODREDBE |
|---|---|---|
| **Neni 1**<br>**Qëllimi** | **Article 1**<br>**Purpose** | **Član 1**<br>**Cilj** |
| Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohen tarifat noteriale për të gjitha veprimet dhe shërbimet e noterëve në Republikën e Kosovës. | This Administrative Instruction sets out notary fees for all notarial acts and services in the Republic of Kosovo. | Ovim Administrativnim uputstvom utvrđuju se javnobeležničke tarife za sve radnje i usluge javnih beležnika na Kosovu. |
| **Neni 2**<br>**Fushëveprimi** | **Article 2**<br>**Scope** | **Član 2**<br>**Delokrug** |
| Dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ janë të obligueshme për të gjithë noterët dhe zyrat noteriale në Republikën e Kosovës. | Provisions of this Administrative Instruction are mandatory for all notaries and notary offices in the Republic of Kosovo. | Odredbe ovog Administrativnog uputstva su obavezujuće za sve javne beležnike i javnobeležničke kancelarije u Republici Kosovo. |
| **Neni 3**<br>**Përkufizimet** | **Article 3**<br>**Definitions** | **Član 3**<br>**Definicije** |
| 1. Shprehjet e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë këtë kuptim: | 1. Terms used in this Administrative Instruction have the following meaning: | 1. Izrazi upotrebljeni u ovom Administrativnom uputstvu imaju sledeće značenje: |
| 1.1 **Tarifë noteriale -** nënkupton vlerë monetare si kundërvlerë e | 1.1. **Notary fee -** means the monetary value as a counter value of the service | 1.1. **Javnobeležnička tarifa -** podrazumeva novčanu vrednost kao |

| | | |
|---|---|---|
| shërbimit për aktin noterial dhe shërbimet përkatëse ligjore apo teknike të kryera nga noteri. | for a notarial act and relevant legal or technical services performed by the notary. | protivvrednost usluge za javnobeležnički akt i odgovarajuće pravne ili tehničke usluge pružane od strane javnog beležnika. |
| 1.2 **Akt Noterial -** nënkupton aktin profesional të lëshuar nga noteri. | 1.2 **Notarial act -** means the professional act issued by a notary. | 1.2 **Javnobeležnički akt** – podrazumeva stručan akt izdat od javnog beležnika. |
| 1.3 **Palë -** nënkupton çdo person fizik apo juridik që lidhin punë juridike dhe kërkon lëshimin e aktit të noterizuar nga noteri. | 1.3**. Party** - means any natural or legal person who enters into a legal work and requests the issuance of a notarized act by a notary. | 1.3**. Stranka** – podrazumeva svako fizičko ili pravno lice koje stupa u pravne poslove i zahteva izdavanje overenog akta od strane javnog beležnika. |
| 1.4 **Pjesëmarrës** - nënkupton çdo person fizik apo juridik që, pos palës, merr pjesë gjatë punës juridike që kryhet dhe kërkon lëshimin e aktit të noterizuar nga noteri | 1.4**. Participant** - means any natural or legal person who, apart from the party, participates in the legal work performed and requests the issuance of a notarized act by a notary. | 1.4**. Učesnik** - podrazumeva svako fizičko ili pravno lice koje pored stranke učestvuje u pravnim poslovima i zahteva izdavanje overenog akta od strane javnog beležnika. |
| 1.5 **Transaksion** - nënkupton secilën punë juridike që kryhet nga noteri me anë të aktit noterial. | 1.5**. Transaction** - means any legal work performed by a notary through a notarial act. | 1.5**. Transakcija** – podrazumeva svaki pravni posao koji obavlja javni beležnik putem javnobeležničkog akta. |
| 1.6 **Vlera e transaksionit** - nënkupton vlerën e sendit apo të drejtës që është objekt i aktit të noterit, bazuar në vlerësimin e sendit, pronës së luajtshme apo të paluajtshme që e kryejnë personat | 1.6**. Transaction value** - means the value of the asset or the right that is the subject of the notarial act, based on the assessment of the asset, movable or immovable property performed by a qualified or | 1.6**. Vrednost transakcije** - podrazumeva vrednost stvari ili prava koje je predmet javnobeležničkog akta, na osnovu procene stvari, pokretne ili nepokretne imovine, koju vrše kvalifikovana ili ovlašćena fizička ili |

| | | |
|---|---|---|
| fizik apo juridik të kualifikuar apo autorizuar. | authorized natural or legal persons. | pravna lica. |
| **Neni 4**<br>**Pagesa e noterit për shërbimet noteriale** | **Article 4**<br>**Payment of the notary for notarial services** | **Član 4**<br>**Isplata za usluge javnog beležnika** |
| 1. Për ofrimin e shërbimeve noteriale, noteri paguhet sipas tarifave të përcaktuara me këtë Udhëzim Administrativ dhe ka të drejtë në kompensimin për punën dhe shpenzimet e bëra për shërbimin përkatës noterial. | 1. For the provision of notarial services, the notary is paid in accordance with the fees set out in this Administrative Instruction and is entitled to compensation for the work and expenses incurred for the respective notary service. | 1. Za pružanje usluga javnog beležnika, javni beležnik se isplaćuje u skladu sa tarifama koje su utvrđene ovim Administrativnom uputstvom, i ima pravo na naknadu za rad i nastale troškove za odgovarajuću uslugu javnog beležnika. |
| 2. Noteri është i obliguar që gjatë ofrimit të shërbimit noterial të veprojë në mënyrën më të përshtatshme ekonomike për palën, përveç rastit kur pala edhe pas pranimit të këshillës së noterit, kërkon të veprohet ndryshe. | 2. The notary is obliged when providing notary services to act in the most appropriate economic manner for the party, except the case when the party even after receiving the advice of a notary, requires to act otherwise. | 2. Javni beležnik je u obavezi da tokom pružanja javnobeležničkih usluga deluje na najprikladniji isplativiji način za stranku, osim u slučaju kada stranka i nakon primanja saveta od strane javnog beležnika, zahteva da deluje drugačije. |
| **Neni 5**<br>**Bazat për caktimin e tarifave noteriale** | **Article 5**<br>**Basis for the determination of notary fees** | **Član 5**<br>**Osnove za utvrđivanje javnobeležničkih tarifa** |
| 1. Kompensimi për punën e noterit varet nga lloji i punës dhe caktohet sipas njërës nga bazat e më poshtme: | 1. The compensation for the work of a notary depends on the type of work and is determined based on one of the following bases: | 1. Naknada za rad javnog beležnika zavisi od vrste posla i utvrđuje se prema jednom od sledećih osnova: |
| 1.1. sipas vlerës së lëndës- | 1.1. Based on the value of the case- | 1.1. prema vrednosti predmeta – |

| | | |
|---|---|---|
| transaksionit të aktit noterial,<br>1.2. sipas kohës së shpenzuar,<br><br>1.3. në shumën fikse. | transaction of the notarial act,<br>1.2. Based on the time spent,<br><br>1.3. At a fixed amount. | transakcije javnobeležničkog akta,<br>1.2. prema utrošenom vremenu,<br><br>1.3. u fiksnom iznosu. |
| **Neni 6**<br>**Obligimi i noterit për zbatimin e tarifave noteriale** | **Article 6**<br>**Obligation of a notary to apply notary fees** | **Član 6**<br>**Obaveza javnog beležnika za primenu javnobeležničkih tarifa** |
| 1. Noteri është i obliguar ta zbatojë këtë tarifë për secilin rast individual të përcaktuar në këtë Udhëzim Administrativ. | 1. A notary is obliged to apply this fee for each individual case defined with this Administrative Instruction. | 1. Javni beležnik je dužan da primeni ovu tarifu za svaki pojedinačni slučaj utvrđen ovim Administrativnim uputstvom. |
| 2. Ndalohet caktimi apo kontraktimi i kompensimit për punën e kryer apo kompensimi i shpenzimeve në shumat më të larta apo më të ulëta se shumat e parapara me këtë Udhëzim. | 2. It is prohibited to determine or contract compensation for work performed or compensation of expenses in amounts higher or lower than the amounts provided with this Instruction. | 2. Zabranjeno je utvrđivanje ili ugovaranje naknade za obavljeni rad ili naknade troškova u iznosima većim ili manjim od iznosa predviđanih ovim uputstvom. |
| **Neni 7**<br>**Caktimi i kompensimit sipas vlerës së lëndës-transaksionit** | **Article 7**<br>**Determination of compensation based on the value of the case-transaction** | **Član 7**<br>**Utvrđivanje naknade prema vrednosti predmeta-transakcije** |
| 1. Për përpilimin e akteve noteriale dhe kryerjen e punëve tjera noteriale tek të cilat është e njohur vlera e objektit të transaksionit, apo ajo mund të caktohet, kompensimi caktohet në bazë të vlerës së objektit të transaksionit konkret. | 1. For the compilation of notarial acts and the performance of other notarial works in which the value of the subject of the transaction is known, or it can be determined, the compensation is determined based on the value of the object | 1. Za sastavljanje javnobeležničkih akata i obavljanje drugih javnobeležničkih poslova kod kojih je poznata, ili se može utvrditi vrednost predmeta transakcije, naknada se utvrđuje na osnovu vrednosti predmeta konkretne transakcije. |

| | | |
|---|---|---|
| | of the respective transaction. | |
| 2. Baza për caktimin e kompensimit është çmimi real i tregut të vlerës së sendit që është lëndë e aktit noterial, pa zbritjen e borxheve. | 2. Basis for determination of the compensation is the real market price of the value of the asset that is the subject of the notarial act, without deduction of debts. | 2. Osnova za utvrđivanje naknade je realna tržišna cena vrednosti stvari koja je predmet javnobeležničkog akta, bez odbitka dugova. |
| 3. Përjashtimisht, noteri mund të caktoj vlerën e tregut pa marr parasysh vlerën të cilën pala apo pjesëmarrësit tjerë në transaksion e paraqesin si vlerë të objektit të punës juridike, nëse vlera e paraqitur e tillë nuk i përgjigjet vlerës së tregut. Në atë rast, noteri duhet të marr parasysh vlerën e sendit që realizohet në qarkullimin e zakonshëm juridik, duke marrë parasysh cilësitë e sendit dhe faktet e njohura zyrtare siç janë: | 3. Exceptionally, a notary may determine the market value, regardless of the transaction value the party or other participants in the transaction present as a value of the object of legal work, if such transaction value presented is inconsistent with market value. In that case, the notary must take into account the value of the asset in the ordinary legal transaction, taking into account the features of the asset and the officially known facts such as: | 3. Izuzetno, javni beležnik može odrediti tržišnu vrednost bez obzira na vrednost koju stranka ili drugi učesnici u transakciji prikazuju kao vrednost predmeta pravnog posla, ako prikazana vrednost ne odgovara tržišnoj vrednosti. U tom slučaju, javni beležnik mora voditi računa o vrednosti stvari koja se ostvaruje u redovnom pravnom prometu, uzimajući u obzir kvalitet stvari i zvanično poznate činjenice kao što su: |
| 3.1. vlerësimet e organit kompetent tatimor për ato apo sende të ngjashme; | 3.1. assessments by the competent tax authority for those or similar assets; | 3.1. procene nadležnog poreskog organa za njih ili slične stvari; |
| 3.2. shënimet e organeve tjera publike apo gjyqësore; | 3.2. records of other public or judicial bodies; | 3.2. beleške drugih javnih ili pravosudnih organa; |
| 3.3. çmimet të cilat për sende të ngjashme arrihen në ankande publike; | 3.3. values for related assets at public auctions; | 3.3. cene koje se za slične stvari postižu na javnim licitacijama; |
| 3.4. rastet e sigurimeve nga zjarri apo krahasimet me vlerat e | 3.4. cases of fire insurance or comparisons to the turnover values in | 3.4. slučajevi osiguranja od požara ili upoređivanja sa vrednostima prometa |

| | | |
|---|---|---|
| qarkullimit në kontrata të ngjashme të realizuara, apo vlerësimet e dhëna në ekspertiza të ndryshme në procedura administrative dhe gjyqësore si dhe vlerësime të ngjashme. | similar contracts, or estimates provided in different expertise in administrative and judicial procedures and other similar estimates. | u sličnim realizovanim ugovorima, ili procene date u različitim veštačenjima u upravnim i sudskim postupcima, kao i slične procene. |
| 4. Po që se, edhe pas veprimit të noterit në kuptim të paragrafit paraprak të këtij neni palët nuk pajtohen me atë vlerësim, noteri mund t'i udhëzoj dhe kërkoj ekspertizën e organit kompetent mbi çmimin real të tregut të atij sendi. | 4. If, even after the action of the notary in relation to the previous paragraph of this article, the parties do not agree with that estimate, the notary can instruct and request the expertise of the competent body on the real market value of that asset. | 4. Ako se i nakon javnobeležničke radnje u smislu prethodnog stava ovog člana stranke se ne slažu sa tom procenom, javni beležnik može da upućuje i zatraži veštačenje nadležnog organa o realnoj tržišnoj ceni te stvari. |
| 5. Në të kundërtën, nëse palët nuk veprojnë dhe insistojnë në kryerjen e kësaj punë juridike konkrete, me çmim të objektit të dyshimtë, atëherë noteri do të veproj sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe parandalimin e financimit të terrorizmit. | 5. On the contrary, if the parties do not act and insist on carrying out this concrete legal work, at the cost of a dubious object, then the notary will act in accordance with the provisions of the legislation in force to prevent money laundering and prevent the financing of terrorism. | 5. U suprotnom, ako stranke ne postupaju i ne insistiraju na izvršenju ovog konkretnog pravnog posla, po cenu sumnjivog predmeta, onda će javni beležnik postupiti u skladu sa odredbama važećeg zakonodavstva o sprečavanju pranja novca i sprečavanju finansiranja terorizma. |
| 6. Nëse lëndë e punës juridike janë kërkesat, merret vetëm kërkesa kryesore pa kërkesat dytësore, duke përfshirë por pa u kufizuar në: dënimi kontraktor, shpenzimet procedurale. | 6. If claims are subject of the legal work, only the main claim is taken without the secondary claims, including but not limited to: contractual penalty, procedural costs. | 6. Ako su predmet pravnog posla potraživanja, uzima se samo glavni zahtev bez sporednih potraživanja, uključujući, ali ne ograničavajući se na: ugovornu kaznu, troškove postupka. |

| Neni 8<br>**Punët juridike mbi ndarjen dhe këmbimin e pasurisë** | Article 8<br>**Legal works on the division and exchange of property** | Član 8<br>**Pravni poslovi za podelu i razmenu imovine** |
|---|---|---|
| Gjatë përpilimit të akteve noteriale që si lëndë e kanë ndarjen e pasurisë së përbashkët bashkëshortore, ndarjen fizike apo këmbimin si dhe tek punët e ngjashme juridike me marrëveshje të palëve, si bazë për caktimin e kompensimit merret vlera e përgjithshme e pasurisë që është objekt i punës juridike. | When compiling notarial acts that have as subject the division of the joint marital property, physical division or exchange, as well as in similar legal works with the agreement of the parties, as a basis for determination of compensation shall be considered the total value of the property that is subject of legal work. | Prilikom sastavljanja javnobeležničkih akata koji za predmet imaju podelu zajedničke imovine supružnika, fizičku podelu ili razmenu, kao i kod sličnih pravnih poslova uz dogovor stranaka, kao osnova za utvrđivanje naknade uzima se ukupna vrednost imovine koja je predmet pravnog posla. |
| **Neni 9**<br>**Punët juridike bashkëshortore dhe trashëgimore** | **Article 9**<br>**Legal works between spouses and inheritance** | **Član 9**<br>**Pravni poslovi između supružnika i nasledni pravni poslovi** |
| 1. Gjatë përpilimit të akteve noteriale mbi Kontratat bashkëshortore, si bazë për caktimin e kompensimit merret vlera e pasurisë së të dy palëve kontraktuese që është objekt i kontratës.<br><br>2. Gjatë përpilimit të aktit noterial mbi disponimin në rast të vdekjes, si bazë për caktimin e kompensimit merret vlera e pasurisë së trashëgimlënësit e zvogëluar për borxhet, respektivisht vlera e pjesës së pasurisë që është objekt i disponimit. | 1. When compiling notarial acts on marital contracts, as a basis for determination of compensation shall be considered the value of property of both contraction parties subject of the contract.<br><br>2. When compiling notarial acts to be disposed in case of death, as a basis for determination of compensation shall be considered the value of property of the testator deducted of debts, respectively the value of the part of property subject of the disposal. | 1. Prilikom sastavljanja javnobeležničkih akata za Bračne ugovore, kao osnova za utvrđivanje naknade uzima se vrednost imovine dveju ugovornih stranaka, koja je predmet ugovora<br><br>2. Prilikom sastavljanja javnobeležničkog akta o raspoloživosti u slučaju smrti, kao osnova za utvrđivanje naknade uzima se vrednost ostaviočeve imovine umanjena za dugove, odnosno vrednost dela imovine koja je predmet raspolaganja. |

| Neni 10<br>Kontratat ekonomike në lidhje me shoqëritë tregtare dhe personat e tjerë juridik | Article 10<br>Commercial contracts for business organizations and other legal persons | Član 10<br>Ugovori u privredi u vezi sa privrednim društvima i drugim pravnim licima |
|---|---|---|
| 1. Për përpilimin e aktit noterial për Kontratat ekonomike bazë për caktimin e kompensimit është vlera e objektit të caktuar në kontratë. | 1. For compilation of notarial act for commercial contracts, as a basis for determination of compensation shall be considered the value of the object determined in the contract. | 1. Za sastavljanje javnobeležničkog akta za Ugovore u privredi, osnova za utvrđivanje naknade je vrednost predmeta određenog u ugovoru. |
| 2. Për përpilimin e aktit noterial mbi themelimin e shoqërive tregtare dhe personave tjerë juridik dhe për vërtetimin e vendimeve të organit drejtues të personave të tillë, kompensimi caktohet në bazë të kohës së shpenzuar. | 2. For compilation of notarial act for the establishment of business organizations and other legal person and for authentication of decisions of governing body of such persons, the compensation shall be determined based on the time spent. | 2. Za sastavljanje javnobeležničkog akta za osnivanje privrednih društava i ostalih pravnih lica i za overu odluka rukovodećeg organa takvih lica, naknada se utvrđuje na osnovu utrošenog vremena. |
| 3. Gjatë përpilimin të aktit noterial mbi bartjen e aksioneve në shoqërinë tregtare si bazë merret vlera e tregut e aksionit të bartur. | 3. When compiling notarial acts for the transfer of shares to a business organization, as a basis shall be considered the market value of the transferred share. | 3. Prilikom sastavljanja javnobeležničkog akta za prenos akcija na privredno društvo, kao osnova se uzima vrednost prenete akcije. |
| 4. Gjatë përpilimit të akteve noteriale mbi ristrukturimin e shoqërive tregtare, bazë për caktimin e kompensimit është vlera e përgjithshme e kapitalit bazë të të gjitha shoqërive tregtare. | 4. When drafting notarial acts on the restructuring of companies, the basis for determining the compensation is the total value of the share capital of all companies. | 4. Prilikom sastavljanja javnobeležničkog akta za restrukturiranje privrednih društava, osnova za utvrđivanje naknade je ukupna vrednost osnovnog kapitala svih privrednih društava. |
| 5. Nëse objekt i punës juridike janë letrat me vlerë të cilat qarkullojnë në tregun e | 5. If the subject of legal work is securities circulating in the stock market, the | 5. Ako su predmet pravnog posla hartije od vrednosti koje cirkulišu na tržištu berzi, |

| | | |
|---|---|---|
| bursave, baza për caktimin e kompensimit llogaritet sipas kursit të tregut në bursat të vlefshme në ditën e lidhjes së punës juridike. | basis of compensation shall be considered pursuant to the market rate in the stock market valid on the date when the legal work is concluded. | osnova za utvrđivanje naknade obračunava se prema tržišnom kursu na važećim berzama na dan sklapanja pravnog posla. |
| **Neni 11**<br>**E drejta e sigurimit sendor, pengut dhe servituti** | **Article 11**<br>**The right to insure property, pledge and easement** | **Član 11**<br>**Pravo na osiguranje stvari, zaloge i službenosti** |
| 1. Tek punët juridike mbi themelimin e hipotekës dhe të drejtave të tjera sendore, si bazë për caktimin e kompensimit merret shuma e limitit të lejuar të kredisë. | 1. For legal works on the establishment of mortgages and other property rights, as a basis for determination of compensation shall be considered the amount of the allowed credit limit. | 1. Kod pravnih poslova za zasnivanje hipoteke i ostalih stvarnih prava, kao osnova za utvrđivanje naknade uzima se iznos dozvoljenog kreditnog limita. |
| 2. Vlera e sigurimit të kërkesës me peng të luajtshëm caktohet sipas lartësisë së vlerës së pengut të marrë. | 2. The value for insurance of a pledge request shall be determined in accordance to the amount of the value of the taken pledge. | 2. Vrednost osiguranja potraživanja zalogom, utvrđuje se prema visini vrednosti preuzete zaloge. |
| **Neni 12**<br>**Obligimet e njëpasnjëshme, kontratat mbi huanë dhe qiranë** | **Article 12**<br>**Repetitious obligations Contracts on loan and lease** | **Član 12**<br>**Uzastopne obaveze, ugovori o zajmu i zakupu** |
| 1. Vlera e së drejtës në detyrimet e ardhshme që përsëriten, caktohen në bazë të vlerës të të gjitha obligimeve të obliguesit për periudhën e përgjithshme kontraktuese, deri në periudhën pesë (5) vjeçare. | 1. The value on the right of future repetitious obligations shall be determined based on the value of all obligations of the obligor for the total contracting period, up to a five (5) year period. | 1. Vrednost prava na buduće obaveze koje se ponavljaju, utvrđuje se na osnovu vrednosti svih obaveza obveznika za opšti ugovorni period, do roka od pet (5) godina. |

| | | |
|---|---|---|
| 2. Tek kontratat mbi huanë dhe kontrata mbi qiranë vlera caktohet sipas periudhës tre (3) vjeçare të huas respektivisht qirasë përveç nëse nuk bëhet fjalë për huanë apo qiranë të lidhur për periudhë më të shkurtë, me ç' rast vlera caktohet sipas huas respektivisht qirasë së përgjithshme. | 2. For contracts on loan or lease the value shall be determined according to three (3) year period of the loan respectively lease, unless it is for a loan or lease concluded for a shorter period, in which case the value shall be determined according to the total loan respectively lease. | 2. Kod ugovora o zajmu i ugovora o zakupu, vrednost se utvrđuje na osnovu perioda zajma od tri (3) godine, odnosno zakupa, osim ako se ne radi o zajmu ili zakupu zaključenom na kraći rok, i tom prilikom se vrednost utvrđuje prema zajmu, odnosni konačnom iznosu zakupa. |
| **Neni 13**<br>**Vlerësimet për punët e ngjashme** | **Article 13**<br>**Determination of fees for similar works** | **Član 13**<br>**Procene za slične poslove** |
| 1. Punët noteriale të cilat nuk janë të përshkruara me këtë Udhëzim Administrativ vlerësohen sipas krahasimit me punët e ngjashme vlera e të cilave është e përcaktuar më këtë Udhëzim Administrativ. | 1. Notary works not specified by this Administrative Instruction shall be evaluated based on comparison with similar works whose value is set out in this administrative instruction. | 1. Javnobeležnički poslovi koji nisu opisani u ovom Administrativnom uputstvu procenjuju se u odnosu na slične poslove čija je vrednost utvrđena ovim Administrativnim uputstvom. |
| 2. Gjatë vlerësimit merren parasysh zgjidhjet tarifore për punët e ngjashme dhe koha e shpenzuar si dhe dispozitat e pjesës së përgjithshme të këtij Udhëzimi. | 2. During the evaluation, the fee solutions for similar works and the time spent shall be considered, as well as the provisions of the general part of this Instruction. | 2. Prilikom procene uzimaju se u obzir tarifna rešenja za slične poslove i utrošeno vreme, kao i odredbe opšteg dela ovog uputstva. |
| **Neni 14**<br>**Caktimi i kompensimit sipas vlerës së sendit** | **Article 14**<br>**Determination of compensation according to the value of the asset** | **Član 14**<br>**Utvrđivanje naknade prema vrednosti stvari** |
| 1. Vlera e sendit dhe kompensimi për punën e noterit e treguar në € (euro), gjendet në pjesën e posaçme të Udhëzimit | 1. The value of the asset and the compensation for the work of the notary shown in € (euro), is found in the special | 1. Vrednost stvari i naknada za rad javnog beležnika iskazana u € (evrima), nalazi se u posebnom delu Uputstva o tarifama i |

| | | |
|---|---|---|
| mbi tarifat dhe është pjesë përbërëse e saj. | part of the Instruction on fees and is an integral part of it. | njegov je sastavni deo. |
| 2. Përpos kompensimit për punë dhe kompensimit të shpenzimeve për punën e kryer të cilën noteri është i obliguar që ta llogarisë në pajtim me këtë Udhëzim Administrativ, noteri ka për obligim që palëve t`ua llogarisë shtesë edhe tatimin e paraparë në vlerën e shtuar. | 2. In addition to compensation for work and compensation of expenses for work performed which the notary is obliged to calculate in accordance with this Administrative Instruction, the notary has the obligation to additionally calculate to the parties the envisaged value added tax. | 2. Pored naknade za rad i naknade troškova za obavljeni rad koje je javni beležnik dužan da obračuna u skladu sa ovim Administrativnim uputstvom, javni beležnik je u obavezi da strankama dodatno obračuna predviđeni porez na dodatu vrednost. |
| **Neni 15**<br>**Dokumentet e pavlefshme dhe të papërdorshme** | **Article 15**<br>**Invalid and unusable documents** | **Član 15**<br>**Nevažeći i neupotrebljivi dokumenti** |
| 1. Nëse akti noterial për shkak të fajit të noterit është i pavlefshëm, ndërsa kopjet, vërtetimet dhe legalizimet e papërdorshme për shkak të mangësive formale për të cilat është përgjegjës noteri, kompensimi nuk paguhet, ndërsa kompensimin e paguar noteri është i obliguar që ta kthej. | 1. When a notarial act is invalid due to notary’s fault, while the copies, certificates and legalizations are unusable due to the formal deficiencies for which the notary is responsible, the party shall not pay the notary fee, and the notary is obliged to refund the already paid compensation. | 1. Ako je javnobeležnički akt nevažeći krivicom javnog beležnika, dok kopije, potvrde i legalizacije neupotrebljive zbog formalnih nedostataka za koje je odgovoran javni beležnik, naknada se ne isplaćuje, dok isplaćenu naknadu javni beležnik je dužan da vrati. |
| 2. Nëse një akt i ri noterial duhet të lëshohet për shkak të gabimit të bërë nga vetë noteri, pala nuk ngarkohet me tarifë noteriale shtesë. | 2. If a new notarial act must be reissued due to the mistake made by the notary himself, the party is not charged with additional notary fee. | 2. Ako treba izdati novi javnobeležnički akt zbog greške samog javnog beležnika, stranci se ne naplaćuje dodatna javnobeležnička tarifa. |

| Neni 16<br>**Pagesa e përbashkët** | Article 16<br>**Joint payment** | Član 16<br>**Zajednička uplata** |
| --- | --- | --- |
| Nëse akti noterial përfshinë më shumë se një palë apo në rastet kur noteri ka ofruar një shërbim noterial për disa palë, të gjitha palët në mënyrë solidare janë përgjegjëse për pagesën e tarifave dhe shpenzimeve që i kanë borxh noterit, përveç nëse palët janë pajtuar ndryshe. | If a notarial act involves more than one party or in cases where a notary has provided a notary service for several parties, all parties are jointly responsible for the payment of fees and expenses owed to a notary, unless agreed otherwise by the parties. | Ako javnobeležnički akt obuhvata više od jedne stranke ili u slučajevima kada je javni beležnik pružio jednu javnobeležničku usluga za više stranaka, sve stranke su solidarno odgovorne za plaćanje tarifa i troškova koje su dužni javnom beležniku, osim ako se stranke nisu drugačije dogovorile. |
| **Neni 17**<br>**Akti noterial me disa transaksione** | **Article 17**<br>**Notarial act with several transactions** | **Član 17**<br>**Javnobeležnički akt sa nekoliko transakcija** |
| Nëse një akt noterial përmban disa transaksione të llojeve të ndryshme, noteri mund të shtojë tarifa shtesë deri në 50 % të tarifës kryesore për secilin transaksion shtesë. | If a notarial act contains several transactions of different types, the notary may add additional charges up to 50% of the main fee for each additional transaction. | Ako jedan javnobeležnički akt sadrži nekoliko transakcija različitih vrsti, javni beležnik može dodati dodatne tarife do 50% glavne tarife za svaku dodatnu transakciju. |
| **Neni 18**<br>**Pagesa e kompensimit dhe paradhënia për ofrimin e shërbimit noterial** | **Article 18**<br>**Payment of compensation and advance payment for the provision of notary service** | **Član 18**<br>**Plaćanje naknade i predujam za pružanje javnobeležničkih usluga** |
| 1. Noteri ka të drejtë në kompensim menjëherë pas punës së kryer. | 1.The notary is entitled to compensation immediately after performing his/her work. | 1. Javni beležnik ima pravo na naknadu odmah nakon obavljenog posla. |

| | | |
|---|---|---|
| 2. Noteri mund të kërkoj që pala gjatë kontraktimit të punës të paguaj paradhënien gjegjëse për shpenzimet e nevojshme me rastin e caktimit të punës në shumën deri në 50 % të tarifës së përcaktuar. Në rast se finalizimi i dokumentit noterial dështon me fajin e palës, noteri ka të drejtë që paradhënien ta mbajë. | 2. A notary may request the party to make an advance payment for the necessary expenses when determining the work, in an amount up to 50% of the determined fee. If the finalization of the notarial document fails through the fault of the party, the notary has the right to keep the advance payment. | 2. Javni beležnik može da traži da stranka za vreme ugovaranja posla uplati odgovarajući predujam za neophodne troškove prilikom utvrđivanja posla u iznosu do 50% utvrđene naknade. U slučaju da finalizacija javnobeležničke isprave ne uspe krivicom stranke, javni beležnik ima pravo da zadrži predujam. |
| 3. Nëse paradhënia nuk është paguar menjëherë apo në afat të cilën e cakton noteri, noteri obligohet për ofrimin e shërbimit noterial vetëm pas pranimit të paradhënies së kërkuar. | 3. If the advance is not paid immediately or within the deadline set by the notary, the notary is obliged to provide the notary service only after receiving the requested advance. | 3. Ako predujam nije isplaćen odmah ili u roku koji je odredio javni beležnik, javni beležnik je dužan da pruži javnobeležničke usluge tek po prijemu traženog predujma. |
| **Neni 19**<br>**Pjesëmarrja e dëshmitarit dhe përkthyesit/interpretit të licencuar gjyqësor** | **Article 19**<br>**Participation of a witness and a licensed court translator/interpreter** | **Član 19**<br>**Učešće svedoka i licenciranog sudskog prevodioca/tumača** |
| Palët në një punë juridike noteriale respektivisht gjatë marrjes së punëve zyrtare janë të obliguar që të paguajnë edhe shpenzimet e pjesëmarrësve të tjerë të ftuar si dëshmitarit, ekspertit dhe përkthyesit/interpertit të licencuar - gjyqësor, sipas marrëveshjes ndërmjet tyre. | The parties in a notarial legal work, respectively while receiving official work, are obliged to pay the expenses of other invited participants as witnesses, expert and licensed court translator/interpreter, based on the agreement between them. | Stranke u javnobeležničkim poslovima, odnosno prilikom primanja službenog poslova, dužne su da plate i troškove ostalih pozvanih učesnika kao svedoke, veštake i licencirane sudske prevodioce/tumače, prema dogovoru između njih. |

| **Neni 20**<br>**Dorëzimi i dokumentacionit dhe faturës** | **Article 20**<br>**Submission of documentation and invoice** | **Član 20**<br>**Predaja dokumentacije i fakture** |
|---|---|---|
| 1.Noteri është i autorizuar dhe i obliguar që palës dhe pjesëmarrësve të tjerë t'ia dorëzoj kopjet dhe përshkrimet e akteve noteriale që i ka përpiluar, vërtetimet, legalizimet/konfirmimet si dhe dokumentet tjera të dedikuara palëve dhe pjesëmarrësve, pasi që janë paguar të gjitha shpenzimet dhe kompensimet. | 1.A notary is authorized and obliged to submit to the party and other participants copies and description of notarial acts developed by him, certificates, legalization and other documents dedicated for the parties and participants, upon the payment in full of the notary fees and other expenses. | 1.Javni beležnik je ovlašćen i dužan da stranci i ostalim učesnicima predaje primerke i opise javnobeležničkih akata koje je sastavio, overio, legalizacije/potvrde kao i ostalu dokumentaciju namenjenu strankama i učesnicima, nakon što su u potpunosti isplaćene javnobeležničke tarife i troškovi. |
| 2. Noteri është i obliguar që palës t'ia lëshojë vërtetimin-faturën fiskale mbi kompensimin e paguar për punën e kryer dhe kompensimin e shpenzimeve, e cila faturë përmban të dhënat si në vijim: | 2. At the time of payment of fees by the party, a notary is obliged to submit to the party the fiscal receipt-invoice for the fee and expenditures paid, containing the following data: | 2. Javni beležnik je dužan da stranci izdaje potvrdu - fakturu za isplaćenu naknadu za obavljen rad i naknadu troškova, faktura koja sadrže sledeće podatke: |
| 2.1. Emrin dhe mbiemrin e noterit, nënshkrimin e tij, adresa e zyrës së noterit dhe kodi i identifikimit personal të noterit; | 2.1. Name and surname of the notary, his signature, the notary office address and personal identification code of the notary; | 2.1. Ime i prezime javnog beležnika, njegov potpis, adresu javnobeležničke kancelarije i kod lične identifikacije javnog beležnika; |
| 2.2. Numrin dhe datën e lëshimit të faturës; | 2.2. Number and date of issuance of invoice; | 2.2. Broj i datum izdavanja fakture; |
